



# Manuali i instalimit

## Kondicioneri Daikin për dhomë



**FTXP20N5V1B9**  
**FTXP25N5V1B9**  
**FTXP35N5V1B9**

**ATXP20N5V1B9**  
**ATXP25N5V1B9**  
**ATXP35N5V1B9**

Manuali i instalimit  
Kondicioneri Daikin për dhomë

**Shqip**

[illegible]

**Daikin Europe N.V.**

- decades under its sole responsibility that the products to which this declaration relates:  
 erklaart in alseine verantwoordelijkheid, dass die Produkte, auf die sich diese Erklärung bezieht:  
 déclare sous sa seule responsabilité que les produits visés par la présente déclaration:  
 verklaart hebbt op eigen verantwoordelijkheid dat de producten waarop deze verklaring betrekking heeft:  
 declara bajo su única responsabilidad que los productos a los que hace referencia esta declaración:  
 dichiara sotto la propria responsabilità che i prodotti a cui è riferita questa dichiarazione:  
 бъявляет под своей ответственностью, что продукция, на которую распространяется это заявление:  
 declara sub sua exclusivă responsabilitate, că produsele a căror declarație este însoțită de prezenta declarație:

## FTXP20N5V1B9, FTXP25N5V1B9, FTXP35N5V1B9, ATXP20N5V1B9, ATXP25N5V1B9, ATXP35N5V1B9,

- 01 are in conformity with the following (directives or) regulation(s) provided that the products are used in accordance with our instructions:  
02  
03 folgende in Reichtlinie oder (Verordnungen) entsprechen, vorausgesetzt, dass diese gemäß unserer Instruktionen verwendet werden.  
04  
05 conformes à la(ux) directive(s) ou à le(ge)m(en)t(s) suivant(s), à condition que les produits soient utilisés conformément à nos instructions:  
06  
07 overeenstemming met de volgende richtlijn(en) of verordening(en), op voorwaarde dat de producten worden gebruikt overeenkomstig onze  
08 instructies:  
09  
10 están en conformidad con la(s) siguiente(s) directiva(s) o reglamento(s), siempre que se utilicen de acuerdo con nuestras instrucciones:  
11  
12 estão em conformidade com a(s) seguinte(s) directiva(s) ou regulamento(s), desde que os produtos sejam utilizados de acordo com as nossas  
13 instruções.

Machinery 2006/42/EC\*\*  
Radio Equipment 2014/53/EU\*

- |    |                                   |    |                            |
|----|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 01 | following the provisions of:      | 10 | under l'aggiunge af:       |
| 02 | gemäß den Bestimmungen in:        | 11 | enligt bestämmelserna för: |
| 03 | conformément aux dispositions de: | 12 | I fremtid I bestemmelse i: |
| 04 | vólgens de bepalingen van:        | 13 | noudadnen samrukisa:       |
| 05 | siguiendo las disposiciones de:   | 14 | za dođizen uslovni:        |
| 06 | secondo le disposizioni di:       | 15 | prema odredbama:           |
| 07 | опирују се на диспозитије из:     | 16 | kovel aži:                 |
| 08 | segundo as disposições de:        | 17 | zgodine z postavitniami:   |
| 09 | в соответствии с положениями:     | 18 | urimad trevedele:          |

- |              |                                                                                                     |                |                                                                                                     |
|--------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 01 Note*     | as set in <A> and judged positively by <B> according to the <b>Certificat</b> <A>                   | 06 Note*       | come delineat în <A> și calificat pozitivamente de către <B> a sensul <b>Certificat</b> <A>         |
| 02 Hinweis*  | we in <A> aufgeführt und von <B> positiv beurteilt, <b>Certificat</b> <A>                           | 07 Sprijinul*  | ajutus publicat în <A> cu valoare benefică am în vedere <B> în conformanță cu <b>Paragraful</b> <A> |
| 03 Remarque* | telles que définies dans <A> et évaluées positivement par <B> conformément au <b>Certificat</b> <A> | 08 Note*       | conforme stabilite în <A> și evaluată pozitivamente por <B> de acord cu o <b>Certificat</b> <A>     |
| 04 Bemerk*   | zoals uitegezet in <A> en positief beoordeeld door <B> overeenkomstig het <b>Certificat</b> <A>     | 09 Privremene* | caz vazează <A> și într-un timp scurt <B> corinao <b>Certificat</b> <A>                             |
| 05 Nota*     | tal como se establece en <A> valorado positivamente por <B> de acuerdo con el <b>Certificat</b> <A> | 10 Bemerk*     | San anfori <A> og positiv vurderet af <B> i henhold til <b>Certificat</b> <A>                       |

- 01\* Dairin Europe N.V. is authorised to compile the Technical Construction File.  
02\* Dairin Europe N.V. hat die Berechtigung die Technische Konstruktionsakte zusammenzustellen.  
03\* Dairin Europe N.V. est autorisée à compiler le Dossier de Construction Technique.  
04\* Dairin Europe N.V. is bevoegd om het Technisch Constructiedossier samen te stellen.  
05\* Dairin Europe N.V. está autorizado a compilar el Archivo de Construcción Técnica.  
06\* Dairin Europe N.V. è autorizzata da compilare il File tecnico di Costruzione.

**DAIKIN**

Hiromitsu Iwasaki

Director

Ostend, 1st of August 2023

- 07<sup>ος</sup> Η Dalkin Europe N.V. είναι εξουσιοδοτημένη να αναλάβει τον Τεχνικό φάκελο κατασκευής.  
08<sup>ος</sup> Η Dalkin Europe N.V. está autorizada a compilar a documentação técnica de fabrico.  
09<sup>ος</sup> Компания Далкин Е.В. уполномочена составлять Комплект проектной документации.  
10<sup>ος</sup> Dalkin Europe N.V. er autorisert til å udarbejde tekniske konstruksjonsdata.  
11<sup>ος</sup> Dalkin Europe N.V. är bemyndigad att sammanställa den tekniska konstruktionsfilen.  
12<sup>ος</sup> Dalkin Europe N.V. har tilrettelagt til komplette den tekniske konstruktionsfilen.

- |    |                                  |    |                                    |
|----|----------------------------------|----|------------------------------------|
| 01 | as amended,                      | 08 | conforme emendado,                 |
| 02 | in der jeweils gültigen Fassung, | 09 | в соответствии с поправками,       |
| 03 | telles que modifiées,            | 10 | sejako izmijenjeno,                |
| 04 | zoals gewijzigd,                 | 11 | med tilføj,                        |
| 05 | zaisl gwen'zged,                 | 12 | med borteaftr endringer,           |
| 06 | en su forma emendada,            | 13 | sellasna kuin ne oival muutettuna, |
| 07 | e successive modifiées,          |    |                                    |
|    | 08 omgjøtt endringer,            |    |                                    |

- [illegible]

- отвечает требованиям, упомянутых ниже директив или нормативных документов при условии эксплуатации данной продукции в соответствии с указаниями инструкций.

- 14 v plátně zničen,
- 15 jako je změřeno amandinina,
- 16 ds modrotisků renkové zšeřel,
- 17 z počtějším zmanami,
- 18 cu amandiněm respactive,
- 19 kakor je bto sremeno,
- 20 kos mudatatsaga,
- 21 s tveřte kameňnia,
- 22 if jis besens redakčas,
- 23 a goziumem,
- 24 v posleđnom plátno vydani,
- 25 dešitjidiť sekivje,

- [illegible]

- [illegible]

- 14 v platném znění,  
15 jako je zmíněno amandamama,  
16 és módosítások rendelkezései,  
17 z późniejszymi zmianami,  
18 cu amendamentele respective,  
19 kakori je bilo spreminjeno,

- [illegible]

- |     |                    |
|-----|--------------------|
| <A> | TCF.RED.DAIKIN.004 |
| <B> | -                  |
| <C> | -                  |

- 13<sup>o</sup> Dairin Europe N.V. on valutuutu bahtmaan Tenissen osastajan.
- 14<sup>o</sup> Společnost Dairin Europe N.V. má oprávnění ke kompilaci souboru technické konstrukce.
- 15<sup>o</sup> Dairin Europe N.V. je ověřen za izadu Datavek a čemiték konstrukci.
- 16<sup>o</sup> A Dairin Europe N.V. jogsall a miszaki konstrukciós dokumentáció szerszámlista.
- 17<sup>o</sup> Dairin Europe N.V. má uprávňovanie k zberu a opracovávanu dokumentácií konštrukčnej.
- 18<sup>o</sup> Dairin Europe N.V. ešte autorizuje sú kompleté Dairinova čemé konstrukcie.

- |                 |                                                                        |
|-----------------|------------------------------------------------------------------------|
| 19 <sup>o</sup> | Dakin Europe N.V. je pooblaščen za sestavo datoteke s tehnično napo.   |
| 20 <sup>o</sup> | Dakin Europe N.V. omogoča dostop do tehničnih dokumentov.              |
| 21 <sup>o</sup> | Dakin Europe N.V. je odgovorna za dostavo Arcta za tehnične tok.       |
| 22 <sup>o</sup> | Dakin Europe N.V. je garanta sudarj s tehničnih konstrukcijskih tala.  |
| 23 <sup>o</sup> | Dakin Europe N.V. je avtorizirala sestavljanje tehniške dokumentacije. |
| 24 <sup>o</sup> | Spodnost Dakin Europe N.V. je opravljanje vzhodni sbor tehničkej ko    |
| 25 <sup>o</sup> | Dakin Europe N.V. Teknik Yapi Dosyasin derlemeye vekildir.             |

UKCA – Safety declaration of conformity

Daikin Europe N.V.

declares under its sole responsibility that the products to which this declaration relates:

FTXP20N5V1B9, FTXP25N5V1B9, FTXP35N5V1B9, ATXP20N5V1B9, ATXP25N5V1B9, ATXP35N5V1B9,

are in conformity with the following directive(s) or regulation(s), provided that the products are used in accordance with our instructions:

S.I. 2008/1597: Supply of Machinery (Safety) Regulations 2008\*\*  
S.I. 2017/1206: Radio Equipment Regulations 2017\*

as amended,

following the provisions of: BS EN 60335-2-40: 2003 + A13: 2012, BS EN IEC 62311: 2020, BS EN IEC 55014-1: 2021, BS EN IEC 55014-2: 2021, BS EN IEC 61000-3-2: 2019 + A1: 2021,  
BS EN IEC 61000-3-2: 2018 + A1: 2020, BS EN 61000-3-3: 2013 + A1: 2019 + A2: 2021, BS EN IEC 61000-3-3: 2013 + A1: 2017 + A2: 2021, EN 301 489-1 V2.2.3, EN 301 489-17 V3.2.4,  
EN 300 328 V2.2.2,

\* as set out in <A> and judged positively by <B> according to the **Certificate <C>**.

\*\* Daikin Europe N.V. is authorised to compile the Technical Construction File.

|     |                    |
|-----|--------------------|
| <A> | TCF.RED.DAIKIN.004 |
| <B> | -                  |
| <C> | -                  |





Hiromitsu Iwasaki  
Director  
Ostend, 1st of August 2023

DAIKIN EUROPE N.V.

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

## Tabela e përmbajtjes

|                                                                                                |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1 Rreth dokumentacionit</b>                                                                 | <b>4</b>  |
| 1.1 Rreth këtij dokumenti.....                                                                 | 4         |
| <b>2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit</b>                                        | <b>4</b>  |
| <b>3 Rreth kutisë</b>                                                                          | <b>6</b>  |
| 3.1 Njësia e brendshme.....                                                                    | 6         |
| 3.1.1 Heqja e aksesorëve nga njësia e brendshme.....                                           | 6         |
| <b>4 Rreth njësive</b>                                                                         | <b>7</b>  |
| 4.1 Plani i sistemit.....                                                                      | 7         |
| 4.2 Gama e operimit.....                                                                       | 7         |
| <b>5 Instalimi i njësive</b>                                                                   | <b>7</b>  |
| 5.1 Përgatitja e vendit të instalimit.....                                                     | 7         |
| 5.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme.....                             | 7         |
| 5.1.2 Kërkesat shtesë të vendit të instalimit për njësinë e jashtme në kohë të ftohta.....     | 7         |
| 5.2 Hapja e njësive të brendshme.....                                                          | 7         |
| 5.2.1 Heqja e panelit të përparmë.....                                                         | 7         |
| 5.2.2 Ri-instalimi i panelit të përparmë.....                                                  | 8         |
| 5.2.3 Heqja e rrjetës së përparme.....                                                         | 8         |
| 5.2.4 Ri-instalimi i rrjetës së përparme.....                                                  | 8         |
| 5.2.5 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike.....                                  | 8         |
| 5.2.6 Si të hapni kapakun e shërbimit.....                                                     | 8         |
| 5.3 Montimi i njësive të brendshme.....                                                        | 8         |
| 5.3.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit.....                                                  | 8         |
| 5.3.2 Si të shpini një vrimë në mur.....                                                       | 9         |
| 5.3.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit.....                                               | 9         |
| 5.3.4 Sigurimi i kullimit.....                                                                 | 10        |
| <b>6 Instalimi i tubacionit</b>                                                                | <b>11</b> |
| 6.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit.....                                                   | 11        |
| 6.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit.....                                                   | 11        |
| 6.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit.....                                                    | 11        |
| 6.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit.....                                                       | 11        |
| 6.2.1 Udhëzime kur kryen lidhjen e tubacionit të ftohësit.....                                 | 11        |
| 6.2.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme.....                              | 12        |
| 6.3 Kontrolli i tubacionit të ftohësit.....                                                    | 12        |
| 6.3.1 Kontrolli për rrjedhje.....                                                              | 12        |
| 6.3.2 Tharje me vakum.....                                                                     | 12        |
| <b>7 Instalimi elektrik</b>                                                                    | <b>12</b> |
| 7.1 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike.....                          | 13        |
| 7.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme.....                                 | 13        |
| <b>8 Përfundimi i instalimit të njësive të brendshme</b>                                       | <b>13</b> |
| 8.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kablos së ndërlidhjes.....               | 13        |
| 8.2 Kalimi i tubave ftohësit përmes vrimës së murit.....                                       | 14        |
| 8.3 Fiksimi i njësive mbi pllakën e montimit.....                                              | 14        |
| <b>9 Konfigurimi</b>                                                                           | <b>14</b> |
| 9.1 Caktimi i një kanali ndryshe të marrësit të sinjalit infrakuq të njësive të brendshme..... | 14        |
| <b>10 Vënia në punë</b>                                                                        | <b>15</b> |
| 10.1 Lista e plotë para komisionimit.....                                                      | 15        |
| 10.2 Kryerja e një testimi.....                                                                | 15        |
| 10.2.1 Kryerja e një ekzekutim testimi në sezonin e dimrit.....                                | 15        |
| <b>11 Hedhja</b>                                                                               | <b>15</b> |
| <b>12 Të dhënat teknike</b>                                                                    | <b>16</b> |
| 12.1 Skema e instalimeve elektrike.....                                                        | 16        |

## 1 Rreth dokumentacionit

### 1.1 Rreth këtij dokumenti



#### INFORMACION

Kontrolloni që përdoruesi e ka dokumentacionin të printuar dhe kërkojini që ta mbajë për referencë në të ardhmen.

#### Audienca e synuar

Instaluesit e autorizuar



#### INFORMACION

Qëllimi i kësaj pajisjeje është përdorimi nga përdoruesit ekspertë ose të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar ose shtëpiak nga jo profesionistë.

#### Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

#### • Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:

- Udhëzimet që DUHET të lexoni mbi sigurinë para instalimit
- Format: Letër (te kutia e njësive të brendshme)

#### • Manuali i instalimit të njësive të brendshme:

- Udhëzimet e instalimit
- Format: Letër (te kutia e njësive të brendshme)

#### • Udhëzuesi referencë i instaluesit:

- Përgatitja e instalimit, praktikat e mira, të dhënat referencë,...
- Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimi më i fundit i dokumentacionit të dhënë botohet në faqen rajonale Daikin të internetit dhe vihet në dispozicion përmes shitësit tuaj.

Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

#### Të dhënat inxhinierike teknike

- Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- **Grupi i plotë** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

## 2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

Instalimi i njësive (shihni "**5 Instalimi i njësive**" ► 7)



#### PARALAJMËRIM

Instalimi duhet të kryhet nga një instalues, zgjedhja e materialeve dhe instalimi duhet të përputhet me legjisllacionin e zbatueshëm. Në Evropë, EN378 është standardi i zbatueshëm.

Vendi i instalimit (shihni **"5.1 Përgatitja e vendit të instalimit"** [p 7])



### KUJDES

- Kontrolloni nëse vendi i instalimit mund të mbajë peshën e njësisë. Instalimi i dobët është i rrezikshëm. Mund edhe të shkaktojë dridhje ose zhurmë të pazakontë në operim.
- Ofron hapësirë të mjaftueshme shërbimi.
- MOS e instaloni njësinë në atë mënyrë që të bjerë në kontakt me tavanin ose muret, sepse mund të shkaktojë dridhje.



### PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).

Lidhja e tubacionit të ftohësit (shihni **"6.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit"** [p 11])



### KUJDES

- Nuk duhet të ketë kallajisje ose saldim në terren për njësitë me ftohës R32 gjatë transportit.
- Gjatë instalimit të sistemit të ftohjes, bashkimi i pjesëve me të paktën njërin pjesë të ngarkuar duhet të kryhet duke marrë parasysh këto kërkesa: brenda hapësirave të zëna bashkimet jo të përhershme nuk lejohen për ftohësin R32, përveç bashkimeve që kryhen në terren dhe që lidhin drejtpërsëdrejti njësinë e brendshme me tubacionin. Bashkimet që bëhen në terren dhe që lidhin drejtpërsëdrejti tubacionin me njësitë e brendshme të loji jo të përhershëm.



### NJOFTIM

- Përdorni dadon e zgjerimit që është vendosur në njësi.
- Për të parandaluar rrjedhje të gazit, vendosni vaj ngrirjeje VETËM në brendësi të pjesës së zgjeruar. Përdorni vaj ngrirjeje për R32 (FW68DA).
- MOS i përdorni sërish kyçet.



### NJOFTIM

- MOS përdorni vaj mineral në pjesën e zgjeruar.
- MOS ripërdorni tubacion nga instalime të mëparshme.
- KURRË mos instaloni tharëse me këtë R32 për të garantuar jetëgjatësinë e saj. Materiali i tharjes mund të shpërbëhet dhe dëmtojë sistemin.



### PARALAJMËRIM

Lidhni tubacionin e ftohësit në mënyrë të sigurt para se të vini kompresorin. Nëse tubacioni i ftohësit NUK është i lidhur dhe valvuli i ndërprerjes është i hapur kur vihet kompresori, atëherë kemi një thithje të ajrit brenda. Kjo do të shkaktojë presion anormal në ciklin e ftohjes, i cili mund të çojë në dëmtimin e pajisjeve dhe madje edhe në lëndim fizik.



### KUJDES

- Ngjeshja e paplotë mund të shkaktojë rrjedhje të gazit të ftohësit.
- MOS ripërdorni ngjeshje. Përdor ngjeshje të reja për të parandaluar rrjedhjen e gazit të ftohësit.
- Përdorni dado ngjeshëse që përfshihen me njësinë. Përdorimi i dadove të ndryshme ngjeshëse mund të shkaktojë rrjedhjen e gazit të ftohësit.



### KUJDES

MOS i hapni valvulet para se të mbarojë zgjerimi i telit. Kjo do të shkaktojë rrjedhje të gazit të ftohësit.



### RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

MOS i hapni valvulet e ndalimit para se të ketë mbaruar tharja me vakum.

Ngarkimi i ftohësit (shihni Ngarkimi i ftohësit)



### PARALAJMËRIM

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.



### PARALAJMËRIM

- Përdorni vetëm R32 si ftohës. Substancat e tjera mund të shkaktojnë shpërthime dhe aksidente.
- R32 përmban gazra serë të fluorinuara. Vlera e tyre për ndikuar te ngrohja globale (GWP) është 675. MOS i lëshoni këto gazra në atmosferë.
- Kur ngarkoni ftohësin, përdorni GJITHMONË doreza dhe syze mbrojtëse.



### NJOFTIM

Për të shmangur avarinë e kompresorit, MOS e ngarkoni më shumë se sasinë e specifikuar të ftohësit.



### PARALAJMËRIM

KURRË mos prekni në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë ftohës me rrjedhje aksidentale. Kjo mund të rezultojë në plagë të rënda të shkaktuara nga morthi.

Instalimi elektrik (shihni **"7 Instalimi elektrik"** [p 12])



### PARALAJMËRIM

Pajisja DUHET instaluar në përputhje me rregullat kombëtare të instalimeve elektrike.



### PARALAJMËRIM

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një elektrikist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjisllacionin në fuqi.

### 3 Rreth kutisë



#### PARALAJMËRIM

- Nëse furnizimit me energji elektrike i mungon faza-N ose është e gabuar, pajisja mund të prishet.
- Vendos tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësinë të tubat e shërbimeve utilitare, përthithësi i fryrjeve apo tokëzimet e telefonit. Tokëzimi i paplotë mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instalo siguresat e kërkuara ose siguresat e qarkut.
- Siguroji instalimet elektrike me lidhëse kabllorsh që kabllot të mos bin në kontakt me tehet e mprehta apo tubacionin, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS përdorni tela të ngjitur, kordona zgjatues ose lidhje nga një sistem yjesh. Ato mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.
- MOS e instaloni kondensatorin për përparimin e fazës, sepse kjo pajisje është e pajisur me një inverter. Kondensatori për përparimin e fazës ul performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.



#### PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kablllo me shumë bërthama për kabllot e furnizimit me energji elektrike.



#### PARALAJMËRIM

Përdorni një lloj çelësi për ndërprerje me të gjitha polet me të paktën 3 mm mes hapësirave të pikës së kontaktit që ofron ndërprerje të plotë sipas kategorisë III të mbitensionit.



#### PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.



#### PARALAJMËRIM

MOS e lidhni furnizimin e energjisë me njësinë e brendshme. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



#### PARALAJMËRIM

- MOS përdorni pjesë elektrike të blera lokalisht brenda produktit.
- MOS e degëzoni furnizimin me energji elektrike për pompën e kullimit, etj. nga blloku terminal. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



#### PARALAJMËRIM

Sistemin e instalimit të ndërlidhjes mbajeni larg tubave të bakrit pa izolim termal, sepse mund të jenë shumë të nxehta.



#### RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Të gjitha pjesët elektrike (përfshirë kondensatorët) marrin korrent nga furnizimi me energji. MOS i prekni me duar të zhveshura.



#### RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Shkëputni furnizimin me energji elektrike për më shumë se 10 minutave dhe matni voltazhin te terminalet e kondensatorëve të qarkut kryesor ose përbërësve elektrikë para shërbimit. Voltazhi DUHET të jetë më i vogël se 50 V DC para se të prekni përbërësit elektrikë. Për vendndodhjen e terminaleve, shikoni skemën e instalimeve elektrike.

Përfundimi i instalimit të njësisë së brendshme (shihni Përfundimi i instalimit të njësisë së jashtme)



#### RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

- Kontrolloni që sistemi të jetë tokëzuar si duhet.
- Ndërpritni furnizimit me energji para kryerjes së shërbimit.
- Instaloni kapakun e kutisë së çelësit para se të lidhni furnizimin me energji.

Komisionimi (shihni "10 Vënia në punë" [p 15])



#### RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



#### RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI



#### KUJDES

MOS kryeni operimin testues kur punoni te njësitë e brendshme.

Kur kryeni operimin testues, JO VETËM njësia e jashtme, por edhe njësia e lidhur e brendshme do të operojë. Të punuarit në një njësi të brendshme kur kryhet një operim testues është i rrezikshëm.



#### KUJDES

MOS vini gishtat, shufra apo sende të tjera te pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit. MOS e hiqni mbrojtësen e ventilatorit. Kur ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë, shkaktohet lëndim fizik.



#### A2L ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

### 3 Rreth kutisë

#### 3.1 Njësia e brendshme




#### INFORMACION

Figurat e mëposhtme janë thjesht shembull dhe NUK mund të përputhen plotësisht me planin e sistemit tuaj.

##### 3.1.1 Heqja e aksesorëve nga njësia e brendshme

1 Hiqni:

- qesen e aksesorëve që gjendet në fund të paketimit,
- plakën e montimit bashkëngjitur pjesës së pasme të njësies së brendshme.



- a Manuali i instalimit
- b Manuali i përdorimit
- c Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë
- d Filtër aromatizues i apatitit prej titani dhe filtri i grimcave të argjendta
- e Vidha e montimit të njësies së brendshme (M4×12L). Referojuni "8.3 Fiksimi i njësies mbi plakën e montimit" [p 14].
- f Bateri e thatë AAA.LR03 (alkali) për ndërfaqen e përdoruesit
- g Zotëruesi i ndërfaqes së përdoruesit

- h Ndërfaqja e përdoruesit  
i Pllaka e montimit

## 4 Rreth njësisë




A2L

### ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

### 4.1 Plani i sistemit



### 4.2 Gama e operimit

Përdore sistemin në kufijtë vijues të temperaturës dhe lagështisë për përdorim të sigurt dhe të efektshëm.

| Modaliteti i operimit    | Fusha e veprimit                                                                                                                                          |
|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ftohja <sup>(a)(b)</sup> | <ul style="list-style-type: none"> <li>Temperatura jashtë: -10~48°C DB</li> <li>Temperatura brenda: 18~32°C DB</li> <li>Lagështia brenda: ≤80%</li> </ul> |
| Ngrohja <sup>(a)</sup>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>Temperatura jashtë: -15~24°C DB</li> <li>Temperatura brenda: 10~30°C DB</li> </ul>                                 |
| Tharja <sup>(a)</sup>    | <ul style="list-style-type: none"> <li>Temperatura jashtë: -10~48°C DB</li> <li>Temperatura brenda: 18~32°C DB</li> <li>Lagështia brenda: ≤80%</li> </ul> |

<sup>(a)</sup> Një pajisje sigurie mund ta ndalojë operimin e sistemit nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

<sup>(b)</sup> Kondensimi dhe pikimi i ujit mund të ndodhë nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

## 5 Instalimi i njësisë

### 5.1 Përgatitja e vendit të instalimit



#### PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).



#### PARALAJMËRIM

Pajisa që përdor ftohës R32 duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose ngrohës elektrik po në gjendje pune). Madhësia e dhomës duhet të jetë siç specifikohet në masat e përgjithshme paraprase mbi sigurinë.


### 5.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme



#### INFORMACION

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

- **Rryma e ajrit.** Sigurohu që asgjë të mos bllokojë rrymën e ajrit.
- **Kullimi.** Sigurohu që uji i kondensuar mund të hiqet siç duhet.
- **Izolimi i murit.** Kur kushtet në mur kalojnë 30°C dhe kur në mur vendoset një lagështi relative prej 80% ose ajër i freskët, atëherë kërkohet izolimi shtesë (minimumi 10 mm trashësi, sfungjer polietileni).
- **Forca e murit.** Kontrolloni nëse muri ose dyshemeja janë të qëndrueshëm për të mbështetur peshën e njësisë. Nëse ka rrezik, përforconi murin ose dyshemenë para instalimit të njësisë.
- **Hapësira.** Instaloni njësinë të paktën 1,8 m nga dyshemeja dhe mbani parasysh këto kërkesa për distancat nga muret dhe tavan:



### 5.1.2 Kërkesat shtesë të vendit të instalimit për njësinë e jashtme në kohë të ftohta


Mbroni njësinë e jashtme kundër reshjeve të drejtpërdrejta të dëborës dhe kujdesuni që njësia e jashtme të mos mbulohet KURRË me dëborë.

Në zona me reshje të mëdha dëbore është shumë e rëndësishme të zgjidhet një vend instalimi ku bora NUK ndikon te njësia. Nëse është e mundur rënia e pjesshme e dëborës, sigurohuni që bobina e shkëmbyesit të nxehësishë NUK ndikohet nga dëbora. Nëse është e nevojshme, instaloni një kapak dëbore ose strehë dhe një bazament.

## 5.2 Hapja e njësisë së brendshme

### 5.2.1 Heqja e panelit të përparmë

- 1 Mbajeni panelin e përparmë nga kapëset në të dy krahët dhe hapeni.




a Mbajtëset e panelit

- 2 Hiqni panelin e përparmë duke e shtyrë nga e majta ose e djathta dhe duke e tërhequr para.

**Rezultati:** Boshti i panelit të përparmë në 1 anë do të shkëputet.

## 5 Instalimi i njësisë

- 3 Shkëputni boshtin e panelit të përparmë në anën tjetër po njësoj.



a Boshti i panelit të përparmë

### 5.2.2 Ri-instalimi i panelit të përparmë

- 1 Ngjitni panelin e përparmë. Drejtoni boshtet me slotet dhe shtyjini përbrenda deri në fund.
- 2 Mbyllni panelin e përparmë ngadalë dhe shtypni në qendër në të dy krahët.


### 5.2.3 Heqja e rrjetës së përparme



#### KUJDES


Mbaj veshur pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (doreza mbrojtëse, syze sigurie,...) kur kryen instalimin, mirëmbajtjen ose servisin e sistemit.

- 1 Hiqni panelin e përparmë për të hequr filtrin e ajrit.
- 2 Hiqni 2 vidha (kategoria 20~35) ose 3 vidha (kategoria 50~71) nga rrjeta e përparme.
- 3 Shtyni për poshtë 3 grremçat e sipërm të shënuar me një simbol prej 3 rathësh.



a Grremçi i sipërm  
b Simboli me 3 rathë

- 4 Ne rekomandojmë hapjen e kapakut të xhepit para heqjes së rrjetës së përparme.
- 5 Vendosni të dy duart poshtë mesit të rrjetës së përparme, shtyjeni për lart dhe pastaj drejt jush.




### 5.2.4 Ri-instalimi i rrjetës së përparme

- 1 Instaloni rrjetën e përparme dhe shtrëngoni fort 3 grremçat e sipërm.
- 2 Vendosni 2 vida sërish në rrjetën e përparme.

- 3 Instaloni filtrin e ajrit dhe pastaj montoni panelin e përparmë.

### 5.2.5 Heqja e kapakut të kutisë së instalimeve elektrike


- 1 Hiqni rrjetën e përparme.
- 2 Hiqni 1 vidhë nga kutia e instalimeve elektrike.
- 3 Hapni kapakun e kutisë së instalimeve elektrike duke tërhequr pjesën e dalë sipër kapakut.
- 4 Lironi mbajtësen në fund dhe hiqni kapakun e kutisë së instalimeve elektrike.



a Mbajtësja  
b Pjesa e dalë sipër kapakut  
c Vida

### 5.2.6 Si të hapni kapakun e shërbimit

- 1 Hiqni 1 vidhë nga kapaku i shërbimit.
- 2 Tërhiqni horizontalisht kapakun e shërbimit nga njësia.




a Vidha e kapakut të shërbimit  
b Kapaku i shërbimit

## 5.3 Montimi i njësisë së brendshme


### 5.3.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit

- 1 Instalimi i përkohshëm i pllakës së montimit.
- 2 Niveloni pllakën e montimit.
- 3 Shënoni qendrat e pikave të shpimit në mur duke përdorur një matës. Vendoseni metrin matës te simboli ">".
- 4 Mbaroni instalimin duke siguruar pllakën e montimit në mur duke përdorur vidha M4×25L (furnizuar nga klienti).



**INFORMACION**

Kapaku i portës së tubit të hequr mund të mbahet në një xhep të pllakës së montimit.



- a Pikat e fiksimit të pllakës së montimit të rekomanduar
- b Xhep për kapakun e portës së tubit
- c Mbjatëset për vendosjen e një niveluesi
- d Përmes vrimës së murit Ø65 mm
- e Pozicioni i zorrës së kullimit
- f Pozicioni për metrin te simboli ">"

- g Fundi i tubit të gazrave
- h Fundi i tubit të lëngjeve
- i1 Qendra e vrimës së tubacionit: 160 mm në të majtë
- i2 Qendra e vrimës së tubacionit: 170 mm për të djathtë
- j Qendra e njësisë
- k Përdorni matës siç tregohet


**5.3.2 Si të shponi një vrimë në mur****KUJDES**

Për muret që përmbajnë një kornizë ose dërrasë metalike, përdorni një tub të futur në mur dhe veshje muri te mekanizmi i furnizimit përmes vrimës për të parandaluar një nxehtësi të mundshme, shok elektrik apo zjarr.

**NJOFTIM**

Sigurohuni të izoloni boshllëqet përreth tubave me material izolues (siguruar nga instaluesi) për të parandaluar rrjedhjen e ujit.

- Hapni një mekanizëm furnizimi 65 mm të madh përmes vrimës në mur me një pjerrësi tatëpjetë drejt pjesës së jashtme.
- Vendosni një tub muri të futur në vrimë.
- Vendosni një veshje muri në tubin e murit.




- a Tubacioni i futur në mur
- b Stuko
- c Kapaku i vrimës së murit

- Pas përfundimit të instalimeve, vendosjes së tubacionit të ftohësit dhe kullimit, MOS harroni të izoloni boshllëkun me stuko.


**5.3.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit****INFORMACION**

Për të lidhur tubacionin në krahun e djathtë, në fund djathtas, në krahun e majtës ose në fund majtas, kapaku i portës së tubit DUHET të hiqet.

- Prisni kapakun e portës së tubit nga brenda rrjetës së përparme duke përdorur një sharrë në formë U-je.



- Hiqni çdo rruhdje përgjatë pjesës së prerjes duke përdorur një limë gjilpërë gjysmë të rumbullakët.



## 5 Instalimi i njësies

### ! NJOFTIM

MOS përdorni pinca për të hequr kapakun e portës së tubit, sepse kjo do të dëmtojë rrjetën e përparme.


### 5.3.4 Sigurimi i kullimit

Sigurohu që uji i kondensuar mund të hiqet siç duhet. Kjo përfshin:

- Udhëzimet e përgjithshme
- Lidhjen e tubacionit të kullimit me njësinë e brendshme
- Kontrollin për rrjedhje uji


### Udhëzimet e përgjithshme

- **Gjatësia e tubit.** Mbajeni tubacionin e kullimit sa më të shkurtër të jetë e mundur.
- **Madhësia e tubit.** Nëse kërkohet zgjatimi i zorrës së kullimit ose tubacioni i futur i kullimit, përdorni pjesë të përshtatshme që përputhen me fundin e pjesës së përparme të zorrës.




### ! NJOFTIM

- Instaloni zorrën e kullimit me një pjerrësi tatëpjetë.
- Laqet NUK lejohen.
- MOS e fusni pjesën fundore të zorrës në ujë.




- **Zgjatimi i zorrës së kullimit.** Për ta zgjatur zorrën e kullimit, përdorni një zorrë me diametër të brendshëm Ø16 mm. MOS harroni të përdorni tub për izolimin e nxehtësisë në pjesën e brendshme të zorrës së zgjatimit.



- a Zorrë kullimi siguruar me njësinë e brendshme
- b Tubi i izolimit të nxehtësisë (siguruar nga klienti)
- c Zorrë zgjatimi për kullim


- **Tub i pathyeshëm klorid polivinili.** Kur lidhni një tub të pathyeshëm klorid polivinili (vlere nominale Ø13 mm) direkt me zorrën e kullimit si dhe me tubacionin e futur, përdorni një fole kullimi që sigurohet nga klienti (vlere nominale Ø13 mm).



- a Zorrë kullimi siguruar me njësinë e brendshme
- b Foleja e kullimit me vlerë nominale Ø13 mm (siguruar nga klienti)
- c Tub i pathyeshëm klorid polivinili (siguruar nga klienti)

- **Kondensimi.** Merr masa kundër kondensimit. Izolo tubacionin e plotë të kullimit në ndërtesë.

- 1 Vendosni zorrën e kullimit në tubin e kullimit siç tregohet në figurën vijuese, që të MOS nxirret nga tubi i kullimit.




### Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas

### i INFORMACION

Kur del nga fabrika tubacioni është nga krahun e djathtë. Për tubacionin e krahut të majtë, hiqni tubacionin nga ana e djathtë dhe instalojeni në anën e majtë.

- 1 Ngjitni zorrën e kullimit me ngjitës adeziv te fundi i tubave të ftohësit.
- 2 Mbështilleni bashkë zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit duke përdorur izolant.



- A Tubacioni i krahut të djathtë
- B Tubacioni fundor djathtas
- C Tubacioni fundor prapa
- a Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të djathtë
- b Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin fundor

### Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas

### i INFORMACION


Kur del nga fabrika tubacioni është nga krahun e djathtë. Për tubacionin e krahut të majtë, hiqni tubacionin nga ana e djathtë dhe instalojeni në anën e majtë.

- 1 Hiqni vidhën e fiksimit të izolimit në krahun e djathtë dhe hiqni zorrën e kullimit.
- 2 Hiqni kandelën e kullimit në anën e majtë dhe ngjiteni me anën e djathtë.

### ! NJOFTIM


MOS përdorni vaj lubrifikues (vaj ftohësi) në kandelën e kullimit kur e vendosni brenda. Kandelja e kullimit mund të përkeqësohet dhe shkaktojë rrjedhje kullimi nga kandelja.

- 3 Vendosni zorrën e kullimit në krahun e majtë dhe mos harroni ta shtërngoni me vidhën e fiksimit; përndryshe mund të ketë rrjedhje uji.



- a Vidha e fiksimit të izolimit  
b Zorra e kullimit


- 4 Ngjitni zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit nga ana fundore duke përdorur izolant.



- A Tubacioni i krahut të majtë  
B Tubacioni prapa majtas  
C Tubacioni fundor majtas  
a Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të majtë  
b Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të majtë në fund

## Kontrolli për rrjedhje uji

- Hiqni filtrat e ajrit.
- Hidhni ngadalë rreth 1 l ujë në tabakanë e kullimit dhe kontrolloni për rrjedhje uji.



## 6 Instalimi i tubacionit

### 6.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit

#### 6.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit



#### NJOFTIM

Tubacioni dhe pjesë të tjera presioni do të jenë të përshtatshme për ftohësin. Përdorni bakër fosforik dhe deoksidues pa shtresa për tubacionin e ftohësit.

- Materialet e huaja brenda tubave (përfshirë vajrat për fabrikimin) duhet të jenë  $\leq 30$  mg/10 m.

#### Diametri i tubacionit të ftohësit

Përdorni të njëjtat diametra si lidhjet te njësia e jashtme:

| Diametri periferik i tubit (mm) |                     |
|---------------------------------|---------------------|
| Tubacioni i lëngjeve            | Tubacioni i gazrave |
| Ø6,4                            | Ø9,5                |

#### Materiali i tubacionit të ftohësit

- Materiali i tubacionit:** bakër fosforik dhe deoksidues pa shtresa për e ftohësit
- Lidhjet me ngjeshje:** Përdor vetëm material të kalitur.
- Shkalla e kalitjes dhe trashësia e tubacioneve:**


| Diametri periferik (Ø) | Shkalla e kalitjes | Trashësia (t) <sup>(a)</sup> |  |
|------------------------|--------------------|------------------------------|--|
| 6,4 mm (1/4")          | Kalitur (O)        | $\geq 0.8$ mm                |  |

<sup>(a)</sup> Në varësi të legjislacionit në fuqi dhe presionit maksimal në gjendje të punë të njësisë (shihni "PS High" te pllaka e emrit të njësisë), mund të kërket një trashësi më e madhe e tubacionit.

#### 6.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit

- Përdor sfungjer polietileni si material izolimi:
  - me një shkallë transferimi të nxehtësisë mes 0,041 dhe 0,052 W/mK (0,035 dhe 0,045 kcal/mh°C)
  - me një rezistencë ndaj ngrohjes prej të paktën 120°C
- Trashësia e izolimit:

| Diametri periferik i tubit (Ø <sub>p</sub> ) | Diametri i brendshëm i izolimit (Ø <sub>i</sub> ) | Trashësia e izolimit (t) |
|----------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------------------------|
| 6,4 mm (1/4")                                | 8~10 mm                                           | $\geq 10$ mm             |



Nëse temperatura është më e lartë se 30°C dhe lagështia është më e madhe se RH 80% (lagështia relative), trashësia e materialeve të izolimit duhet të jetë të paktën 20 mm për të parandaluar kondensimin mbi sipërfaqen e izolimit.

### 6.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit




**RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI**


#### 6.2.1 Udhëzime kur kryen lidhjen e tubacionit të ftohësit

Merrni parasysh udhëzimet vijuese kur lidhni tubat:

- Vidhni sipërfaqen e brendshme të telit të zgjeruar me vaj eteri ose esteri kur lidhni dadon e telit të zgjeruar. Shtrëngojeni 3 ose 4 herë me dorë, para se ta shtrëngoni mirë.



- Përdorni GJITHMONË 2 çelësa së bashku kur lironi një dado të telit të zgjeruar.
- Përdorni GJITHMONË një çelës dhe çift rotullues së bashku për të shtrënguar dadon e telit të zgjeruar kur lidhni tubacionin. Kjo kryhet për të parandaluar plasaritjen dhe rrjedhjet e dados.



- a Çift rotullues  
b Çelës  
c Bashkues tubacioni  
d Dado teli të zgjeruar

## 7 Instalimi elektrik

| Madhësia e tubacionit (mm) | Çift rrotullues për shtrëngim (N•m) | Dimensionet e telit të zgjeruar (A) (mm) | Forma e telit zgjerues (mm) |
|----------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------|-----------------------------|
| Ø6,4                       | 15~17                               | 8,7~9,1                                  |                             |
| Ø9,5                       | 33~39                               | 12,8~13,2                                |                             |
| Ø12,7                      | 50~60                               | 16,2~16,6                                |                             |

### 6.2.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme




#### ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

- **Gjatësia e tubit.** Mbajeni tubacionin e ftohësit sa më të shkurtër të jetë e mundur.

- 1 Lidhni tubacionin e ftohësit me njësinë duke përdorur **lidhjet e telit të zgjeruar**.
- 2 **Izoloni** tubacionin e ftohësit, kabllon e ndërlidhjes dhe zorrën e kullimit të njësisë e brendshme si vijon:



- a Tubi i gazrave
- b Izolimi i tubit të gazrave
- c Kabloja e ndërlidhjes
- d Tubi i lëngjeve
- e Izolimi i tubit të lëngjeve
- f Ngjitësja
- g Zorra e kullimit



#### NJOFTIM

Sigurohu të izolosh të gjithë tubacionin e ftohësit. Çdo tubacion i ekspozuar mund të shkaktojë kondensim.

## 6.3 Kontrolli i tubacionit të ftohësit

### 6.3.1 Kontrolli për rrjedhje



#### NJOFTIM

MOS e tejkaloni presionin maksimal të punës së njësisë (shikoni "PS High" në pllakën e emërimit të njësisë).

- 1 Ngarkoni sistemin me gaz nitrogjeni deri te matësi në një presion prej të paktën 200 kPa (2 atmosferë). Rekomandohet mbajtja në presion deri në 3000 kPa (30 atmosferë) për të kapur rrjedhjet e vogla.
- 2 Kontrolloni për rrjedhje duke përdorur zgjidhjen e testimit me fluska për të gjitha lidhjet.



#### NJOFTIM

GJITHMONË përdor një zgjidhje të rekomanduar testimi me fluskë nga grosisti yt.

KURRË mos përdor ujë me sapun:

- Uji me sapun mund të shkaktojë plasaritje të përbërësve, si dadon e zgjerimit ose kasketën e valvulit të ndalimit.
- Uji me sapun mund të përmbajë kripë, e cila thith lagështinë që do të ngrijë kur tubacioni ftohet.
- Uji me ujë përmban amoniak, i cili mund të çojë në gërryerjen e nyjeve ngjeshëse (mes dados ngjeshëse të tunxhit dhe flakërimit të bakrit).

- 3 Shkarkoni të gjithë gazin nitrogjen.

### 6.3.2 Tharje me vakum

- 1 Zbrazeni sistemin derisa presioni në kolektor të tregojë -0,1 MPa (-1 bar).
- 2 Lëreni siç është për 4-5 minuta dhe kontrolloni presionin:

| Nëse presioni... | Pastaj...                                            |
|------------------|------------------------------------------------------|
| Nuk ndryshon     | Nuk ka lagështi në sistem. Kjo procedurë ka mbaruar. |
| Rritet           | Në sistem ka lagështi. Kaloni në hapin tjetër.       |

- 3 Zbrazeni sistemin për të paktën 2 orë deri sa të arrijë presionin e kolektorit prej -0,1 MPa (-1 bar).
- 4 Pas FIKJES së pompës, kontrolloni presionin për të paktën 1 orë.
- 5 Nëse NUK arrini vakumin e synuar ose NUK MUND të ruani vakumin për 1 orë, bëni këto:
  - Kontrolloni sërish për rrjedhje.
  - Kryeni sërish tharje me vakum.

## 7 Instalimi elektrik



#### RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



#### PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kablo me shumë bërthama për kabllo të furnizimit me energji elektrike.



#### PARALAJMËRIM

Përdorni një lloj çelësi për ndërprerje me të gjitha polet me të paktën 3 mm mes hapësirave të pikës së kontaktit që ofron ndërprerje të plotë sipas kategorisë III të mbitensionit.



#### PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.



#### PARALAJMËRIM

MOS e lidhni furnizimin e energjisë me njësinë e brendshme. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



#### PARALAJMËRIM

- MOS përdorni pjesë elektrike të blera lokalisht brenda produktit.
- MOS e degëzoni furnizimin me energji elektrike për pompën e kullimit, etj. nga blloku terminali. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



#### PARALAJMËRIM

Sistemin e instalimit të ndërlidhjes mbajeni larg tubave të bakrit pa izolim termal, sepse mund të jenë shumë të nxehta.

## 7.1 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike



### NJOFTIM

Rekomandojmë përdorimin e telave të fortë (tek bërthamë). Nëse përdoren telat e bllokuar, rrotulloni ngadalë telat për të konsoliduar fundin e përçuesin për secilin prej përdorim të drejtpërdrejtë në kapësen e terminalit ose vendosjen në një terminal të rrumbullakët të llojit dredhë. Detajet përshkruhen në "Udhëzimet kur bëni lidhjen e instalimeve elektrike" në udhëzuesin referencë të instaluesit.

| Përbërësi                                  |                   |                                                                                |
|--------------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------|
| Kabloja e korrentit                        | Voltazhi          | 220~240 V                                                                      |
|                                            | Faza              | 1~                                                                             |
|                                            | Frekuenca         | 50 Hz                                                                          |
|                                            | Madhësitë e telit | Duhet të zbatoni legjislacionin në fuqi                                        |
| Kabloja e ndërlidhjes                      |                   | Pjesë minimale e kablos prej 2,5 mm <sup>2</sup> dhe që përdoret për 220~240 V |
| Siguresa e rekomanduar në ambient të hapur |                   | 20 A                                                                           |
| Çelës për rrjedhje të tokëzimit            |                   | Duhet të zbatoni legjislacionin në fuqi                                        |

## 7.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme



### PARALAJMËRIM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.




### NJOFTIM

- Mbani linjën e energjisë dhe të transmetimit të ndarë nga njëra-tjetra. Instalimet elektrike të transmetimit dhe furnizimi me energji elektrike mund të kryqëzohen, por NUK mund të punojnë paralel.
- Për të shmangur çdo lloj interferimi elektrik distanca mes të dy instalimeve duhet të jetë GJITHMONË të paktën 50 mm.

Punët elektrike duhen kryer në përputhje me manualin e i instalimit dhe rregullat kombëtare të instalimeve elektrike apo kodin e praktikës.

- Vendoseni njësinë e brendshme në çengelët e pllakës së montimit. Përdorni shenjat "Δ" si udhëzues.




- a Pllaka e montimit (aksesor)
- b Kabloja e ndërlidhjes
- c Udhëzuesi i telit

- Hapnin panelin para dhe pastaj kapakun e shërbimit. Referojuni "5.2 Hapja e njësisë së brendshme" [7].

- Kaloni kabllon e ndërlidhjes nga njësia e jashtme përmes mekanizmit të furnizimit dhe vrima e murit, nëpërmjet pjesës prapa të njësisë së brendshme dhe nga ana para.


**Shënim:** Në rast se kabloja e ndërlidhjes është zhveshur përpara, mbuloni pjesën fundore me izolant.

- Përkulni fundin e kablos për lart.



- a Blloku i terminalit
- b Blloku i përbërësit elektrik
- c Kapësja e kablos


- Zhvishni rreth 15 mm pjesët fundore të telit.
- Përshtatni ngjyrat e telit me numrat e terminalit në bllonet e terminalit të njësisë së brendshme dhe vidhosni mirë telat me terminalet përkatëse.
- Lidhni telin e tokëzimit me terminalin përkatës.
- Fiksoni mirë telat me vidat e terminalit.
- Tërhiqni telat për t'u siguruar që janë të ngjitur në mënyrë të sigurt, pastaj ruani telat me mbajtësen e telave.
- Jepuni telave formë në mënyrë që kapaku i shërbimit të përputhet mirë, pastaj mbylleni atë.



## 8 Përfundimi i instalimit të njësisë së brendshme

### 8.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kablos së ndërlidhjes

- Pas përfundimit të tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe lidhjes elektrike, mbështillni bashkë tubat e ftohësit, kabllon e ndërlidhjes dhe zorrën e kullimit duke përdorur izolantin. Përkoni të paktën gjysmën e gjerësisë së ngjitëses nga secila radhë.




- a Zorra e kullimit
- b Kabloja e ndërlidhjes
- c Pllaka e montimit (aksesor)
- d Tubacioni i ftohësit
- e Vidha e montimit të njësisë së brendshme M4×12L (aksesor)

## 9 Konfigurimi

f Korniza fundore

### 8.2 Kalimi i tubave ftohësit përmes vrimës së murit

- 1 Rregulloni tubat e ftohësit përgjatë linjës së tubacionit në pllakën e montimit.




- a Zorra e kullimit
- b Stukoni vrimën me stuko ose material stukues
- c Ngjitës adeziv
- d Izolant
- e Pllaka e montimit (aksesor)



#### NJOFTIM


- MOS i përkulni tubat e ftohësit.
- MOS i shtyni tubat e ftohësit brenda kornizës fundore ose rretës së përpame.



- 2 Kalojeni zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit përmes vrimës së murit dhe boshllëkun izolojeni me stuko.

### 8.3 Fiksimi i njësies mbi pllakën e montimit

- 1 Vendoseni njësine e brendshme mbi mbajtëset e pllakës së montimit. Përdorni shënimet "Δ" si udhëzues.



- 2 Shtypni kornizën fundore të njësies me të dy duart për ta vendosur mbi grremçat fundorë të montimit. Sigurohuni që telat NUK ngjeshën kund.

**Shënim:** Siguroni që kabloja e ndërlidhjes NUK kapet te njësia e brendshme.


- 3 Shtypni buzën fundore të njësies së brendshme të dy duart derisa të kapet mirë nga grremçat e pllakës së montimit.
- 4 Siguroni njësine e brendshme me pllakën e montimit duke përdorur 2 vidha të montimit të njësies së brendshme M4×12L (aksesor).

## 9 Konfigurimi

### 9.1 Caktimi i një kanali ndryshe të marrësit të sinjalit infrakuq të njësies së brendshme

Në rast se në 1 dhomë instalohen 2 njësi të brendshme, mund të caktohen adresa të ndryshme për 2 ndërfaqe përdoruesi.

- 1 Hiqni bateritë nga ndërfaqja e përdoruesit.
- 2 Prisni telin e shkurtër bashkues të adresës.



a Teli i shkurtër bashkues i adresës



#### NJOFTIM

Bëni kujdes MOS të dëmtoni pjesët rrethuese kur prisni telin e shkurtër bashkues të adresës.

- 3 Ndizni energjinë elektrike.

**Rezultati:** Kapaku i xhepit të njësies së brendshme do të hapet dhe mbyllet për të caktuar pozicionin e referencës.



#### INFORMACION

Në rast se NUK arrihet ta përfundoni cilësimin në kohë, fikni energjinë elektrike dhe prisni të paktën 1 minutë para se ta ndizni sërish.

- 4 Shtypni njëkohësisht:

| Modeli       | Butonat |
|--------------|---------|
| FTXP dhe ATP | dhe     |

- 5 Shtypni:


| Modeli       | Butonat |
|--------------|---------|
| FTXP dhe ATP |         |

- 6 Zgjidhni:

| Modeli       | Simboli |
|--------------|---------|
| FTXP dhe ATP |         |

- 7 Shtypni:

| Modeli       | Butoni |
|--------------|--------|
| FTXP dhe ATP |        |



- a Llamba e operimit
- b Çelësi ON/OFF i njësies së brendshme

- 8 Shtypni çelësin ON/OFF e njësies së brendshme kur llamba e operimit pulson.

| Adresa                      | Adresa |
|-----------------------------|--------|
| Vendosja në gjendje fabrike | 1      |
| Pas prerjes me pinca        | 2      |



#### INFORMACION

Nëse ciësimi NUK mund të përfundojë kur llamba e operimit po pulsonte, përsëritni procesin e cilësimit nga fillimi.

- 9 Kur cilësimi ka përfunduar, shtypni:

| Modeli        | Butoni                                   |
|---------------|------------------------------------------|
| FTXP dhe ATXP | Mbajeni  të shtypur për rreth 5 sekonda. |

**Rezultati:** Ndërfaqja e përdoruesit do të kthehet në ekranin e mëparshëm.

## 10 Vënia në punë



#### NJOFTIM

GJITHMONË përdorni njësinë me rezistorët elektrikë dhe/ose sensorët/çelësat e presionit. Nëse JO, mund të ndodhë djegia e kompresorit.

### 10.1 Lista e plotë para komisionimit

- Pas instalimit të njësies, kontrolloni artikujt e renditur më poshtë.
- Mbyllni njësinë.
- Ndizni njësinë.

|                          |                                                                                                                                               |
|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> | Lexo udhëzimet e instalimit të plotë, siç përshkruhen në <b>udhëzuesin e instaluesit të referimit</b> .                                       |
| <input type="checkbox"/> | <b>Njësitë e brendshme</b> janë montuar siç duhet.                                                                                            |
| <input type="checkbox"/> | <b>Njësia e jashtme</b> është montuar siç duhet.                                                                                              |
| <input type="checkbox"/> | <b>Hyrja/dalja e ajrit</b><br>Kontrolloni që hyrja dhe dalja e ajrit nga njësia NUK pengohet nga letra, kartoni apo ndonjë material tjetër.   |
| <input type="checkbox"/> | NUK ka <b>faza që mungojnë</b> apo që <b>kthehen mbrapsht</b> .                                                                               |
| <input type="checkbox"/> | <b>Tubat e ftohësit</b> (të gazit dhe lëngut) janë të izoluar termikisht.                                                                     |
| <input type="checkbox"/> | <b>Kullimi</b><br>Sigurohuni që kullimi qarkullon pa probleme.<br><b>Pasoja e mundshme:</b> Uji i kondensuar mund të pikojë.                  |
| <input type="checkbox"/> | Sistemi është <b>tokëzuar</b> siç duhet dhe terminalet e tokëzimit janë shtrënguar.                                                           |
| <input type="checkbox"/> | <b>Signesat</b> ose pajisjet e mbrojtjes të instaluara lokalisht vendosen në përputhje me këtë dokument dhe NUK kanë kaluar në rrugë anësore. |
| <input type="checkbox"/> | <b>Voltazhi i furnizimit me energji elektrike</b> përputhet me voltazhin në etiketën identifikuese të njësies.                                |
| <input type="checkbox"/> | Telat e specifikuar përdoren për <b>kabllon e ndërlidhjes</b> .                                                                               |
| <input type="checkbox"/> | Njësia e brendshme merr sinjale të ndërfaqes së përdoruesit.                                                                                  |
| <input type="checkbox"/> | NUK ka <b>lidhje të lira</b> ose përbërës të dëmtuar elektrikë në kutinë e çelësit.                                                           |

|                          |                                                                                                                          |
|--------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> | <b>Rezistenca e izolimit</b> të kompresorit është <b>NË RREGULL</b> .                                                    |
| <input type="checkbox"/> | NUK ka <b>përbërës të dëmtuar</b> ose <b>tuba të ngjeshur</b> në pjesën e brendshme të njësive të brendshme dhe jashtme. |
| <input type="checkbox"/> | NUK ka <b>rrjedhje të ftohësit</b> .                                                                                     |
| <input type="checkbox"/> | Madhësia e duhur e tubit instalohet dhe <b>tubat</b> izolohehen siç duhet.                                               |
| <input type="checkbox"/> | <b>Valvulet e ndalimit</b> (gazit dhe lëngjeve) në njësinë e jashtme janë plotësisht të hapura.                          |

### 10.2 Kryerja e një testimi

**Kushti paraprak:** Energjia elektrike DUHET të jetë brenda rrezes së specifikuar.

**Kushti paraprak:** Ekzekutimi i testimit mund të kryhet në gjendje ftohje ose ngrohjeje.

**Kushti paraprak:** Referojuni manualit të përdorimit të njësies së brendshme për të caktuar temperaturën, modalitetin e operimit....

- Në gjendjen ftohje, zgjidhni temperaturën më të ulët të programuar. Në gjendje ngrohje, zgjidhni temperaturën më të lartë të programuar. Ekzekutimi i testimit mund të çaktivizohet nëse është e nevojshme.
- Kur të mbarojë ekzekutimi i testimit, caktoni temperaturën në një nivel normal. Në gjendje ftohje: 26~28°C, në gjendje ngrohje: 20~24°C.
- Sigurohuni që të gjitha funksionet dhe pjesët funksionojnë si duhet.
- Sistemi ndalon së operuari 3 minuta pas FIKJES së njësies.

#### 10.2.1 Kryerja e një ekzekutim testimi në sezonin e dimrit

Kur e përdorni kondicionerin në gjendjen e Ftohjes në dimër, kalojeni në operimin e ekzekutimit të testimit duke përdorur metodën vijuese.

- Shtypni njëkohësisht dhe .
- Shtypni .
- Zgjidhni **7**.
- Shtypni .
- Shtypni për të ndezur sistemin.

**Rezultati:** Operimi i ekzekutimit të testimit ndalon automatikisht pas 30 minutave.

- Për të ndaluar operimin, shtypni .



#### INFORMACION

Disa nga funksionet NUK MUND të përdoren në gjendjen e operimit të ekzekutimit të testimit.

Nëse gjatë përdorimit ndodh një avari e energjisë, sistemi rifillon automatikisht menjëherë pas rikthimit të energjisë.

## 11 Hedhja



#### NJOFTIM

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

12 Të dhënat teknike

- Një nëngrup i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- Grupi i plotë i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

12.1 Skema e instalimeve elektrike

Skema e instalimeve elektrike jepet bashkë me njësinë dhe gjendet brenda njësisë së jashtme (ana fundore e pllakës së sipërme).

12.1.1 Legjenda e unifikuar e skemës së instalimeve elektrike

Për pjesët dhe numërimin e zbatuar, referojuni skemës së rrjetit të telave në njësi. Numërimi i pjesëve bëhet me numra arabikë sipas rendit ngjitës për secilën pjesë dhe përfaqësohet te pasqyra poshtë nga "" te kodi i pjesës.

| Simboli | Kuptimi                    | Simboli | Kuptimi                     |
|---------|----------------------------|---------|-----------------------------|
|         | Çelësi                     |         | Tokëzimi mbrojtës           |
|         |                            |         |                             |
|         | Lidhja                     |         | Tokëzimi mbrojtës (vidhë)   |
|         | Lidhësi                    |         | Detektori                   |
|         | Tokëzimi                   |         | Lidhësi i relesë            |
|         | Instalimet në terren       |         | Lidhësi me qark të shkurtër |
|         | Siguresa                   |         | Terminali                   |
|         | Njësia e brendshme         |         | Rripi i terminalit          |
|         | Njësia e jashtme           |         | Kapësja e telit             |
|         | Pajisja reziduale korrenti |         | Ngrohësi                    |

| Simboli | Ngjyra     | Simboli  | Ngjyra     |
|---------|------------|----------|------------|
| BLK     | E zezë     | ORG      | Portokalli |
| BLU     | Blu        | PNK      | Rozë       |
| BRN     | Kafe       | PRP, PPL | E purpurt  |
| GRN     | Jeshil     | RED      | E kuqe     |
| GRY     | Gri        | WHT      | E bardhë   |
| SKY BLU | Blu qielli | YLW      | E verdhë   |

| Simboli                                                                          | Kuptimi                                        |
|----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|
| A*P                                                                              | Qarku i stampuar                               |
| BS*                                                                              | Butoni shtytës NDEZUR/FIKUR, çelësi i operimit |
| BZ, H*O                                                                          | Sinjalizuesi                                   |
| C*                                                                               | Kondensatori                                   |
| AC*, CN*, E*, HA*, HE*, HL*, HN*, HR*, MR*_A, MR*_B, S*, U, V, W, X*A, K*R_*, NE | Lidhja, lidhësi                                |
| D*, V*D                                                                          | Dioda                                          |
| DB*                                                                              | Ura e diodës                                   |
| DS*                                                                              | Çelësi DIP                                     |
| E*H                                                                              | Ngrohësi                                       |
| FU*, F*U, (për karakteristikat referojuni PCB brenda njësisë)                    | Siguresa                                       |

| Simboli                  | Kuptimi                                               |
|--------------------------|-------------------------------------------------------|
| FG*                      | Lidhësi (baza e kornizës)                             |
| H*                       | Rripi                                                 |
| H*P, LED*, V*L           | Llamba e pilotit, dioda që rrezaton dritë             |
| HAP                      | Dioda që rrezaton dritë (monitori i shërbimit jeshil) |
| HIGH VOLTAGE             | Voltazh i lartë                                       |
| IES                      | Sensori inteligjent i syve                            |
| IPM*                     | Modul inteligjent i energjisë                         |
| K*R, KCR, KFR, KHuR, K*M | Rele magnetike                                        |
| L                        | Me rrymë                                              |
| L*                       | Bobinë                                                |
| L*R                      | Reaktor                                               |
| M*                       | Motori ingranues                                      |
| M*C                      | Motori i kompresorit                                  |
| M*F                      | Motori i ventilatorit                                 |
| M*P                      | Motori i pompës së kullimit                           |
| M*S                      | Motori i lëkundjes                                    |
| MR*, MRCW*, MRM*, MRN*   | Rele magnetike                                        |
| N                        | Neutral                                               |
| n=*, N=*                 | Numri i kalimeve përmes bërthamës së ferritit         |
| PAM                      | Rregullimi i gjerësisë së pulsit                      |
| PCB*                     | Qarku i stampuar                                      |
| PM*                      | Moduli i energjisë                                    |
| PS                       | Ndërrimi i energjisë                                  |
| PTC*                     | Termistori PTC                                        |
| Q*                       | Tranzitori bipolar me portë të izoluar (IGBT)         |
| Q*C                      | Çelësi                                                |
| Q*DI, KLM                | Çelësi i rrjedhjes së tokëzimit                       |
| Q*L                      | Protektor mbingarkimi                                 |
| Q*M                      | Çelësi termal                                         |
| Q*R                      | Pajisja reziduale korrenti                            |
| R*                       | Rezistencë                                            |
| R*T                      | Termistor                                             |
| RC                       | Marrësi                                               |
| S*C                      | Çelësi i kufizimit                                    |
| S*L                      | Çelësi i pluskimit                                    |
| S*NG                     | Detektori i rrjedhjes së ftohësit                     |
| S*NPH                    | Sensori i presionit (i lartë)                         |
| S*NPL                    | Sensori i presionit (i ulët)                          |
| S*PH, HPS*               | Çelësi i presionit (i lartë)                          |
| S*PL                     | Çelësi i presionit (i ulët)                           |
| S*T                      | Termostat                                             |
| S*RH                     | Sensori i lagështisë                                  |
| S*W, SW*                 | Çelësi i operimit                                     |
| SA*, F1S                 | Mbrojtës i fryrjes                                    |
| SR*, WLU                 | Marrësi i sinjalit                                    |
| SS*                      | Çelës i përzgjedhësit                                 |
| SHEET METAL              | Pllaka e fiksuar e rripit terminal                    |
| T*R                      | Transformuesi                                         |
| TC, TRC                  | Transmetuesi                                          |
| V*, R*V                  | Varistori                                             |

| Simboli  | Kuptimi                                                                        |
|----------|--------------------------------------------------------------------------------|
| V*R      | Ura e diodës, tranzitori bipolar me portë të izoluar (IGBT) moduli i energjisë |
| WRC      | Telekomanda uajrles                                                            |
| X*       | Terminali                                                                      |
| X*M      | Ripi i terminalit (bloko)                                                      |
| Y*E      | Bobinë valvuli e zgjerimit elektronik                                          |
| Y*R, Y*S | Bobinë valvuli e solenoidit përmbys                                            |
| Z*C      | Bërthamë ferriti                                                               |
| ZF, Z*F  | Filtër zhurme                                                                  |





**DAIKIN ISITMA VE SOĞUTMA SİSTEMLERİ SAN.TİC. A.Ş.**

Gülsuyu Mahallesi, Fevzi Çakmak Caddesi, Burçak Sokak, No:20, 34848 Maltepe

İSTANBUL / TÜRKİYE

Tel: 0216 453 27 00

Faks: 0216 671 06 00

Çağrı Merkezi: 444 999 0

Web: [www.daikin.com.tr](http://www.daikin.com.tr)

Copyright 2023 Daikin

**DAIKIN EUROPE N.V.**

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

3P748643-1D 2024.02